



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit 7 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancës së 46-të të mbajtur me datë 12 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 09-28 nga viti 2020, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndën me numër 09-28/1 me datë 02.01.2020 sepse akuzat nga denoncimi se gjoja ekziton konflikt i interesave gjatë realizimit të procedurës për dhënje me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore – arë me sipërfaqe prej 637m² e cila është me PK në komunën kadastrale, jashta qytetit nuk janë vërtetuar.

Lënda me numër 09-28/1 me datë 02.01.2020, të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-28/1 me datë 02.01.2020 është formuar në bazë të denoncimit anonim me akuza se ekziston gjendje e konfliktit të interesave gjatë realizimit të procedurës së dhënjes me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore – arë me sipërfaqe prej 637m² e cila gjendet me PK në komunën kadastrale, jashta qytetit, gjegjësisht është theksuar se Udhëheqësi i njësisë rajonale në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në, duke shfrytëzuar pozitën e vet si person udhëheqës ka arritur që të fiton në shfrytëzim tokën e caktuar shtetërore nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe të njëjtën ta paraqet në emër të bashkëshortes së tij Parcela e përmendur sipas akuzave në denoncim paraprakisht është përdorur si rrugë për qasje për personat të cilët kanë pronë të vete, mirëpo me gjendjen e re të shkaktuar dhe me fitimin e të drejtës për shfrytëzim, personave iu është pamundësuar të ken qasje deri tek pronat e tyre. Në shtojcë është dorëzuar Shpallje publike nr. për dhënje me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore me sipërfaqe prej 3 hektarë.

Komisioni shtetëror, me qëllim të vërtetimit e akuzave në denoncim, nga Agjensioni për kadastrë të patundshmërive kërkoi këto informacione:

- Në pronësi të kujt gjendet toka bujqësore – arë me e cila gjendet me PK në komunën kadastrale, jashta qytetit
- Të dorëzohet Vërtetim nga rishikimi e historiatit për regjistrimet e bëra në Kadastrën e patundshmërive për tokën në PK në komunën kadastrale jashta qytetit (vërtetim për lëvizjen e tokës së PK në komunën kadastrale jashta qytetit)

Pastaj, nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave është kërkuar:

- Vallë personi është Udhëheqës i njësisë rajonale së Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në
- Vallë personit të njëjtë i është dhënë me qira tokë bujqësore në pronësi shtetërore – arë me e cila është me PK në komunën kadastrale, jashta qytetit
- Nëse PK në komunën kadastrale, jashta qytetit është dhënë me qira personit të njëjtë, të dorëzohet dokumentacioni i plotë për dhënje me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore për sipërfaqe prej 3 hektarë, të cilën e ka realizuar Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave nëpërmjet Shpalljes publike

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Agjensioni për kadastrë të patundshmërive, është konstatuar se toka bujqësore – arë prej e cila është me PK në komunën kadastrale, jashta qytetit, me të drejtë pronësi Republika e Maqedonisë shikuar në fletëpronësinë numër, komuna kadastrale - jashta qytetit e cila është dorëzuar si shtojcë. Më tej, në përputhje me Vërtetimin për rishikim të historisë së shënimeve të bëra për PK në KK - jashta qytetit nga viti 1996 me hyrjen në fuqi të Kadastrës së patundshmërive për KK – jashta qytetit, në procedurën për regjistrim sistematik, parcela e përmendur është regjistruar si RM, gjithashtu gjendet edhe sot, me çka nuk është vërtetuar akuza se Udhëheqësi i njësisë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në Sveti Nikole ka arritur të fiton në shfrytëzim tokën shtetërore të përmendur nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe të njëjtën ta shënon në emër të bashkëshoret.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave është konstatuar se personi i punësuar në vendin e Këshilltarit për menaxhim, përpunim dhe analizë të të dhënave nga regjistrat e ministrisë, Sektori për organizim dhe koordinim të njësisë rajonale PE nr. /1 me datë 07.08.2018 dhe ka autorizim për kryerje të përkohshme të punëve dhe detyrave të punës në vendin e punës Udhëheqës i njësisë rajonale me Vendim nr. /19 me datë 15.07.2019. Më tej, nga Ministria e përmendur informojnë se personi nga nuk ka marrë pjesë në Shpalljen publike, gjegjësisht nuk ka dorëzuar ofertë për pjesëmarrje në Shpallje publike nr. për dhënje me qira të tokës bujqësore në pronësi shtetërore për sipërfaqe prej 3 hektarë.

Në bazë të tërë të sipër përmendur, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave.

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: S. M., bashkëpunor i lartë
Miratoi: m-r V. G., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**
Kryetarë: Biljana Ivanovska